



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-14105/24  
Kaçanik, 28.06.2024

Mbështetur në nenin 29 dhe 30 të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 59 të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.60/01-12895/20 të datës 30.06.2020, të pikës 5 paragrafi 4.3 e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës Nr. 60/02-32223/23 për vitin 2024 të datës 28.12.2023, të Propozim Vendimit të Kryesuesit të Kuvendit 01Nr. 60/01-14105/24 prej datës 14.06.2024, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 28 qershor 2024, mori këtë:

#### V E N D I M

#### PËR REALIZIMIN E NJË VIZITE ZYRTARE STUDIMORE E ANËTARËVE TË KUVENDIT DHE TË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS KAÇANIK JASHTË VENDIT - NË NJË NGA VENDET E RAJONIT

1. Me këtë Vendim, vendoset të realizohet një vizitë zyrtare studimore e Anëtarëve (Këshilltarëve) të Kuvendit dhe të Ekzekutivit të Komunës Kaçanik, jashtë vendit -në një nga vendet e rajonit.
2. Vizita zyrtare studimore nga pika 1. e këtij vendimi, realizohet me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet komunave me vendin që do të realizohet.
3. Vizita zyrtare studimor nga pika 1. e këtij vendimi, do të realizohet në muajin tetor ose nëntor të vitit 2024.
4. Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me Shefat e GP të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës, do të kujdesën për përcaktimin e vendit dhe agjendës së vizitës.
5. Shpenzimet për realizimin e vizitës nga pika 1 e këtij vendimi do t'i bartë Komuna e Kaçanikut, ndërkaq do të kujdeset t'i zbatoj, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 –Për Procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës.

#### Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Kryesuesi i Kuvendit;
3. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave;
4. Arkivi.

